



PËRGATITJET PËR CENSUSIN KOMBËTAR TË 2022 NË SHQIPËRI

A ËSHTË GATI INSTITUTI I
STATISTIKAVE TË PËRFSHIJË
MINORITETET ROM DHE EGJIPTIAN
NË PROCESIN E INTERVISTAVE?

Përmbajtja

Hyrje _____	1
Metodologjia _____	1
Problemet gjatë Censurit të 2011 _____	2
Pilotimi i Censurit të ri në tetor 2021 _____	3
Problematika dhe sfida _____	7
Rekomandime për INSTAT _____	8
Rekomandime dhe Follow-up për OSHC-të Rome dhe Egjiptiane _____	9
Bibliografia _____	10

Shkurtime

OSHC – Organizata të Shoqërisë Civile

INSTAT – Instituti i Statistikave

KMSH – Komiteti Shtetëror i Minoriteteve

OSFA – Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë

PNUD – Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

Hyrje

Ky material ka si qëllim të sjellë në vëmendje të INSTAT-it dhe të gjithë grupeve të interesit shqetësimet lidhur me Censusin e 2022 dhe rekomandimet në funksion të përfshirjes dhe realizimit të saktë të numërimit të popullsisë Rome dhe Egjiptiane në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në këtë kuadër, organizata të shoqërisë civile rome, egjiptiane dhe pro dy komuniteteve organizuan një takim konsultues lidhur me Censusin kombëtar që pritet të zhvillohet këtë vit. Një ndër çështjet kryesore të diskutimit ishte procesi i pilotimit të Censunit në disa zona nga data 14 deri më 18 Tetor 2021. Problematikat dhe si pasojë rezultati i Censunit të vitit 2011, i cili u kontestua gjerësisht nga OSHC-të dhe aktivistë Rom dhe Egjiptianë. Si edhe shqetësimet duke marrë parasysh si skenar të mundshëm mos përfshirjen e drejtpërdrejtë të dy pakicave kombëtare në këtë proces. Shqetësimi primar mbetet mos përsëritja e problematikave dhe si pasojë, rezultatet e Censunit të 2011.

Metodologjia

Për përgatitje e këtij dokumenti janë përdorur instrumente sasiorë dhe cilësor për mbledhjen e të dhënave.

- Së pari, puna kërkimore është shtrirë në dokumente dhe raporte të publikuara nga organizata të shoqërisë civile në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. I jemi referuar studimit të realizuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, raporteve të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, studimit të realizuar nga Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome në Elbasan dhe Korçë dhe së fundmi, raporte nga media konvencionale.
- Monitorimi në terren shërbeu për të konfirmuar vështirësitë lidhur me zbatimin e pyetësorit pilot në terren dhe terminologjinë. Mbi të gjitha përforcoi bindjen dhe nevojën për të organizuar trajnime me intervistuesit lidhur me qasjen që duhet të kenë në zonat dhe lagjet ku banojnë familje Rome ose Egjiptiane. Ende sot, anëtarë të dy pakicave

kombëtare, në kushte të vështira ekonomike dhe të pa arsimuar kanë vështirësi për tu identifikuar si pakicë kombëtare me termin korrekt. Në vend të termave të njohur nga ligji Nr. 96/2017 “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, identifikohen me terma denigruese sikurse i njeh popullata shumicë.

- Fokus grupet me vetë komunitetet Rome dhe Egjiptiane si dhe të dhëna nga terreni të ofruara nga organizata të shoqërisë civile gjatë tryezave të organizuara për këtë qëllim. Gjithashtu, ky grup interesi ndau problematikat, shqetësimet dhe rekomandime lidhur me mbarëvajtjen sa më të saktë dhe korrekte të Censurit 2022. Në takimin e parë konsultues ishin të pranishëm shtatë (7) organizata dhe dy (2) përfaqësues nga Komiteti Shtetëror i Minoriteteve nga pakica kombëtare Rome.

Problemet gjatë Censurit të 2011

Censusi i vitit 2011 u shoqërua me një sërë problemesh. Si pasojë e parregullsive dhe mungesës së pjesëmarrjes në masë të pakicave kombëtare Rome dhe Egjiptiane janë raportuar shifra jo reale. Rom janë raportuar vetëm 8’301, ose vetëm 1/8 e popullatës Rome, ku sipas të dhënave të disponuar nga OSHC-të Rome numri faktit luhet nga 80’000 deri në 120’000. Ndërsa nga pakica Egjiptiane janë raportuar vetëm 3’368, ndërkohë sipas organizatave nga kjo pakicë, Ballkano-Egjiptianë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë arrijnë shifrën e rreth 300’000 banorëve.

Por, rezultatet e Censurit të 2011 janë lehtësisht të kundërshtueshme. Sipas studimit të realizuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, në vitin 2014 është realizuar Censusi 2014 “Banesat dhe Popullata Rome në Shqipëri” dhe është mbledhur informacion për 18’276 Rom (Fondacioni Shoqëria E Hapur Për Shqipërinë, 2014). Madje, shifra është më e lartë pasi studimi nuk është shtrirë në rreth pesëmbëdhjetë (15) vendbanime me popullatë të konsiderueshme Rome si dhe nuk u përfshinë në intervistë rreth 464 banesave të konfirmuara si banesa Rome për shkak të mos gjetjes të asnjë familjari në banesë (Fondacioni Shoqëria E Hapur Për Shqipërinë, 2014). Nga ana tjetër, organizata

“Lëvizja Rinore Rome dhe Egjiptiane”, në përfundim të Censusi të popullsisë së minoritetit Egjiptian në Bashkinë Korçë edhe Elbasan, duke i realizuar intervistat derë më derë, raportuan rreth 13’749 anëtarë të minoritetit egjiptian (Elbasan 5’561, Korçë 8’188) (Informim.al, 2021).

Pilotimi i Censurit të ri në tetor 2021

Në zonat që u përzgjedhën për pilotimin e Censurit kishte mangësi. Shoqëria civile Rome dhe Egjiptiane ka kërkuar vazhdimisht takim me autoritetet e Institutit të Statistikave. Iniciativa e disa organizatave nuk mund të ishte e plotë dhe as përfaqësuese pa pjesëmarrjen dhe përfshirjen e të gjithë aktorëve përkatës dhe grupeve të interesit. Lind nevoja të ushtrojmë trysni brenda kornizave ligjorë mbi autoritetet e Censurit për të shmangur problemet dhe sfidat nga Censusi i 2011. Prandaj, takimi konsultues mes organizatave ishte një thirrje e hapur për të propozuar sugjerime dhe sjellë në tryezë shqetësime për t’ia adresuar institucioneve në ngarkim dhe në rastin konkret INSTAT-it.

Së pari, Shoqëria civile Rome dhe Egjiptiane është e shqetësuar rreth saktësisë së rezultatit lidhur me popullatat Rome dhe Egjiptiane si indikatorë kyç në hartimin e politikave dhe shpërndarjen e buxheteve përkundrejt këtyre pakicave kombëtare.

Së dyti, një tjetër shqetësim vjen si pasojë e mungesës së të dhënave demografike dhe me natyrë sociale nga pushteti vendor. Të dhënat nga Bashkitë, në rastin e një pune studimore në terren të mbështetur nga Këshilli Rajonal për Bashkëpunim, nxori në pah se disa nga bashkitë, subjekt i studimit, nuk kishin të dhëna të strukturuar dhe të agreguara sipas banesave dhe problematikave në terren.

Një fakt i tillë vendos në pikëpyetje shpërndarjen e buxhetit sipas nevojave dhe aktiviteteve për ndërhyrje dhe për ti ardhur në ndihmë pakicave kombëtare. Në rast se autoritetet përgjegjëse nuk marrin parasysh rekomandimet që dalin nga organizatat e shoqërisë civile rome dhe egjiptiane lind e drejta për të shtuar mjetet e trysnisë me qëllim ndikimin në këtë vendimmarrje.

Së treti, një nga problemet gjatë pilotimit të Censurit ishte përfshirja e intervistuesve nga pakicat kombëtare Rome dhe Egjiptiane. Për këtë qëllim janë organizuar disa takime me INSTAT për të përfshirë intervistues nga të dy pakicat për të lehtësuar procesin. Me gjithë vështirësitë institucionale, u arrit që të angazhohen tre (3) persona, dy (2) nga Tirana dhe një (1) nga Durrësi. Gjithashtu, një nga organizatat Egjiptiane ka ndarë një format metodologjie me autoritetin në ngarkim se si mund ta zhvillonin Censurin në zonat e përcaktuara. U caktuan disa zona, por jo emra Bashkish. Më vonë u përfshi zona e Selitës e njohur si Pallati me Shigjeta, e cila paraqiti shumë sfida pasi banorët refuzonin t'i përgjigjeshin formularit provë nga frika se mund të bëhej fjalë për prishjen e banesave. Në 4 Tetor nisi puna nga pilotimi i Censurit, ndërsa në datën 11 Tetor u organizua takimi me grupet e interesuara gjë e cila nuk ishte aspak efikase.

Së katërti, në Korçë kishte gjithashtu shqetësime dhe pikëpyetje nga të gjitha pakicat kombëtare lidhur me organizimin dhe shtrirjen e Censurit. Për këtë arsye, buron rekomandimi për të ofruar trajnim të gjithë intervistuesve të cilët do të angazhohen në terren. Si dhe duke marrë parasysh rrethanat e grupeve të marginalizuara, nevojitet trajnim i përshtatur sipas grupit të synuar.

Së pesti, problematikë paraqitet edhe termi i përdorur për tu vetë-deklaruar nga pakicat kombëtare Rome dhe Egjiptiane. Sipas pjesëmarrësve në diskutim dhe monitorimit po ashtu dhe fokus grupeve në terren, pjesëtarë të pakicave kombëtare deklarohen sipas termit që i njih popullata shumicë dhe që janë terma denigrues. Ndërsa në Fier, disa nga familjet Rome janë deklaruar si minoritarë Grekë nga Censusi i 2011. Si pasojë, lind nevoja që të informojmë komunitetet Rome dhe Egjiptiane lidhur me termat e vetë-deklarimit. Akoma më mirë është trajnimi i intervistuesve që në rast si dikush vetë-deklarohet sipas termit denigrues ta përfshijnë automatikisht si pakicë kombëtare Rome ose Egjiptiane, sipas rastit. Së fundmi, intervistuesi mund t'ia lehtësojë pyetjen duke u shprehur se cilës racë i përket i intervistuari.

Së gjashti, një problematikë nga e kaluara mund të jetë përdorimi i termave të kuptueshëm për të gjithë, pakicë kombëtare apo komunitet etno-kulturor. Por ky shqetësim, mori përgjigje dhe u ndryshua.

Së shtati, kohëzgjatja e Censurit nuk është në favor të mbledhjes së të dhënave të sakta duke influencuar negativisht rezultatin. Njëzet (20) minuta mund të jenë pak ose shumë, kohë në dispozicion, në varësi të profilit të intervistuarit. Njëra palë, intervistuesi mund ta shohë thjesht si një punë, ndërsa i intervistuari si humbje kohe. A duhet të përgatisim një raport hije (shadow report) për ta vënë përballë rezultateve të Censurit?

Censuri i ri është i digjitalizuar, dhe ka një afat kohor, sipas informacionit të deritanishëm, intervistuesi nuk mund të largohet nga vendi i intervistës pa përmbushur kohën standarde për plotësimin e pyetësorit të Censurit.

Së teti, një nga problematikat kryesore gjatë pilotimit të Censurit ishte mungesa në përzgjedhje të zonave me popullsi nga pakicat kombëtare Rome dhe Egjiptiane duke mos mundësuar studimin e pengesave që mund të dalin gjatë Censurit. Vëmendje duhet të marrë edhe leximi i formularit të Censurit pasi nuk është i lejuar leximi i alternativave rreth përkatësisë pasi shihet si sugjestionim, ndërkohë i intervistuari duhet të vetë-deklarohet në bazë të vetëdijes.

Së fundmi, ka disa komunitete, kryesisht të shtrira në zona periferike ose të segreguara/veçuara, që për shkak të profilit të marginalizuar, mungesës së arsimit fillor do të paraqesin vështirësi në plotësimin me të dhëna të sakta të Censurit.

Nga sa më sipër, u artikuluan disa sugjerime dhe rekomandime. Para së gjithash, pjesëmarrësit nga OSHC-të Rome dhe Egjiptiane dhe grupe të interesit si liderët në komunitet, ishin të mendimit se nxjerrja e shifrave të sakta për të dy pakicat kombëtare është i mundur vetëm me angazhimin e intervistuesve nga pakicat kombëtare Rome dhe Egjiptiane. Nga ana tjetër, rezistenca nga autoriteti i INSTAT mund të interpretohet si një shenjë për të mohuar angazhimin e drejtpërdrejtë të shoqërisë civile Rome dhe Egjiptiane, si dhe mundësimin e shifrave të sakta të popullsisë Rome dhe Egjiptiane. Me të drejtë lind pyetja: Cili autoritet publik mund të angazhohet në ndihmë të kauzës tonë? Kemi nevojë për një autoritet vendimmarrës që ka pushtetin për të ndërhyrë në favor të rekomandimeve tona.

Në takim ishin të pranishëm edhe përfaqësues të pakicës Rome në Komitetin Shtetëror të Minoriteteve. Pavarësisht se janë organ këshillimor pranë zyrës së kryeministrit, iu kërkuan rekomandime për qytetin e Elbasanit, Tiranës dhe Korçës dhe për të cilat sugjeruan kontakte aktive në komunitet. Pavarësisht se KSHM është organ këshillimor, mund të adresojë rekomandimet dhe shqetësimet e OSHC-ve Rome dhe Egjiptiane drejt autoriteteve përkatëse.

Pjesëmarrësit sugjeruan që:

- Të paraqitet një panoramë e përgjithshme demografike rreth popullatave Rome dhe Egjiptiane përpara se të zhvillohet procesi i numërimit të Censurit. Në këtë mënyrë do të mund të krahasohen rezultatet në fund. Rezultatet e Censurit, sido që të jenë, do të përdoren për të hartuar dhe draftuar politikat dhe buxhetin. Gjithashtu, duhet të gjendet një mekanizëm i cili të influencojë autoritetet përkatëse për të marrë parasysh rekomandimet tona. Do të duhet të ndërtohen aleanca me pakica të tjera kombëtare për të rritur më tej presionin.
- Nëse do të angazhohen anëtarë të pakicave Rome dhe Egjiptiane në procesin e numërimit, do të duhet që të veprojnë në zonat me popullsi kryesisht nga pakicat tona kombëtare. Në rast se INSTAT nuk merr parasysh rekomandimet e OSHC-ve Rome dhe Egjiptiane dhe nuk i formulojnë strukturat e sistemit sipas nevojës, atëherë do të ndërtohet një strukturë paralele. Shqetësimi që lind është nëse sistemi dështon ose rekomandimet nuk merren parasysh të zbatohen. Si do të bindet INSTAT apo struktura të tjera përgjegjëse për të marrë parasysh shqetësimet e ngritura nga OSHC-të. Pavarësisht vullnetit të INSTAT për të përfshirë intervistues nga pakicat kombëtare, nëse një intervistues nga shumica do të shkojë në komunitet nuk do të fitojë besimin e komunitetit i cili në shumicën e rasteve do të kontaktojë me OSHC-të Rome dhe Egjiptiane, sipas rastit, për qartësime të mëtejshme. Nëse ky është një skenar i mundshëm, si do duhet të veprohet?
- Realizimi i një Censuri paraprak do të ishte një pararojë efikase, por nuk do të merrej parasysh pasi vlerësohen vetëm të dhënat e dala nga autoritetet përkatëse/legjitime. Si raste studimi mund të merren disa Bashki dhe zona me

numrin më të madh të pakicave kombëtare Rome dhe Egjiptiane. Raportet e organizatave kombëtare ose ndërkombëtare shpesh here janë marrë parasysh si referenca në studime dhe nga institucionet. Nëse OSHC-të Rome dhe Egjiptiane sugjerojnë statistikat e mbledhura prej tyre, do të duhet të faktohen. Prandaj lind nevoja e ngritjes së një sistemi metodik për mbledhjen e të dhënave.

- Trajnimi i intervistuesve me terminologjinë e saktë, që në rast se dikush deklarohet me terma denigruese, të vetëkuptohet nga intervistuesi që i intervistuari i përket njëres apo tjetres pakicë kombëtare. Ndryshe do ta shënojnë *“si gjithë të tjerë”*. Madje duhet të trajnohen nga vetë OSHC-të Rome dhe Egjiptiane. Në rast se INSTAT e ka të pamundur të mbulojë aktivitetet të tilla, OSHC-të Rome dhe Egjiptiane mund ta marrin përsipër mbulimin e trajnimeve. OSHC-të të marrin parasysh, nëse i lejohet, të mbulojnë logjistikën si transportin apo aksesin në terren. Por me prioritet mbetet sugjerimi që të angazhohen drejtpërdrejtë intervistues nga pakicat Rome dhe Egjiptiane.

Problematika dhe sfida

1. Bashkëpunimi dhe ndërveprimi me INSTAT. Nuk ka informacion nëse INSTAT ka shpallur ndonjë vendim apo njoftim lidhur me ecurinë e Censurit. Gjithashtu, këtë vit është ngushtuar numri i anketuesve.
2. Terminologjia e vetë-deklarimit. Problematike paraqitet edhe termi i përdorur për tu vetë-deklaruar. Sipas pjesëmarrësve në diskutim, pjesëtarë të pakicave kombëtare deklarohen sipas termit që i njeh popullata shumicë dhe që janë termat denigrues. Ndërsa në Fier, disa nga familjet Rome janë deklaruar si minoritarë Grekë.
3. Mungesa e të dhënave. Një tjetër shqetësim vjen si pasojë e mungesës së të dhënave demografike dhe me natyrë sociale nga pushteti vendor.

4. Profili i zonës/komunitetit. Disa komunitete për shkak të profilit të marginalizuar dhe mungesës së arsimit fillor do të paraqesin vështirësi në plotësimin me të dhëna të sakta të Censurit.
5. Kohëzgjatja e Censurit. Koha nuk është në favor të mbledhjes së të dhënave të sakta duke influencuar negativisht rezultatin. Njëzet (20) minuta mund të jenë pak ose shumë kohë në dispozicion, në varësi të profilit të të intervistuarit. Ekziston rreziku që njëra palë, intervistuesi mund ta shohë thjesht si një punë, ndërsa i/e intervistuari/a si humbje kohe.
6. Faktori kohë. Thirrja u hap në muajin Gusht dhe pritej që trajnimi të hapej në muajin Shtator. Por, u realizua në kohën që nisi puna në terren. Mungesa kohës dhe mosdhënia e rëndësisë së duhur krijon probleme. Nëse anketuesit do të zgjidhen vonë nuk do të kemi mundësi t'i trajnojmë në kohë.
7. Dështimi i përpjekjeve të OSHC-ve Rome dhe Egjiptiane. Sistemi dështon ose rekomandimet nuk merren parasysh të zbatohen. Si do të bindet INSTAT apo struktura të tjera përgjegjëse për të marrë parasysh shqetësimet e ngritura nga OSHC-të?

Rekomandime për INSTAT

1. Angazhim të intervistuesve nga pakicat kombëtare Rome dhe Egjiptiane. Në këtë mënyrë do të sigurohet nxjerrja e shifrave të sakta për të dy pakicat kombëtare.
2. Nëse do të angazhohen anëtarë të pakicave Rome dhe Egjiptiane në procesin e numërimit, do të veprojnë në zonat me popullsi kryesisht nga pakicat tona kombëtare.
3. Ofrimi i trajnimeve të gjithë intervistuesve të cilët do të angazhohen në terren. Trajnimi duhet të jetë i përshtatur sipas profilit arsimor dhe social të grupit të synuar me fokus të veçantë terminologjia e vetë-deklarimit.
4. Intervistuesit të përfshijnë automatikisht si pakicë kombëtare Rome ose Egjiptiane, sipas rastit, dikë që vetë-deklarohet ose vetë-identifikohet me terma denigrues ose

intervistuesi t'ia lehtësojë pyetjen duke u shprehur se cilës racë i përket i intervistuari.

5. Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere në komunitetet Rome dhe Egjiptiane për tu vetë-deklaruar sipas përkatësisë së tyre etnike. Informimi i pakicave kombëtare Rome dhe Egjiptiane lidhur me termat e vetë-deklarimit.

Rekomandime dhe Follow-up për OSHC-të Rome dhe Egjiptiane

1. Reagim i shpejtë dhe ndarja në kohë e sugjerimeve dhe rekomandimeve të gjithsecilit pasi të ndahet drafti i parë i dokumentit me listën e problematikave dhe rekomandimeve.
2. Organizatat të përdorin aktivitetet e tyre për të rritur ndërgjegjësimin lidhur me Censusin në zonat ku ushtrojnë aktivitetin e tyre.
3. Gjetja e referencave shkencore për të kundërshtuar të dhënat e kontestueshme që mund të dalin nga INSTAT. Gjithashtu, konsultime me ekspertë të fushës që mund të komentojnë mbi procesin dhe dinamikat.
4. Organizimi i një fushate të mirëfilltë mediatike për të kundërvepruar ndaj çdo rezistence të mundshme nga autoritetet përgjegjëse si INSTAT-i, i mediave në rast se hasim në rezistencën e INSTAT, madje edhe përpara se të nisë procesi. Përdorimi masivisht i medias është një instrument presioni që ka treguar efikasitet.
5. Realizimi i një Censusi paraprak për të ofruar një panoramë të përgjithshme demografike rreth popullatave Rome dhe Egjiptiane përpara se të zhvillohet procesi i numërimit të Censurit. Në këtë mënyrë do të mund të krahasojmë rezultatet në fund.

Bibliografia

- Ligji Nr. 96/2017 “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.
- “Censusi i Popullsisë në Republikën e Shqipërisë 2011”, INSTAT 2011.
- “Censusi 2014 “Banesat dhe Popullata Rome në Shqipëri”, OSFA 2014.
- “Censusi 2021, minoritetet egjiptian dhe rom/ Duhet të korrigjoj gabimet e Censurit 2011”, <https://informim.al/censusi/>, 16.01.2021.